



V2024040190100151746

## STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "VOLAJ KP" shpk

Ne Shkoder , sot me date 26.07.2024 u paraqit personalisht ortakun themelues z.Kristjan Prendi

I cili hartoj kete statut te shoqerise "VOLAJ KP" SHPK mbeshtetur nr ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ligjin 9723 date 03.05.2007 " Per qendern Kombetare te rregjistrimit " Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor ,

### Neni 1

#### KRIJIMI

Shoqeria quhet "VOLAJ KP", (shoqeri me pergjegjesi te kufizuar)eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ( me poshte e quajtur "Shoqeria" )

### Neni 2

**Shoqeria "VOLAJ KP" Shpk** eshte nje shoqeri tregtare , e themeluar nga "ortaku i vetem i shoqerise , i cili pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara . Kontributet e ortakut perbejne kapitalin e regjistruar te shoqerise

### Neni 3

#### Selia dhe emri i shoqerise

3.1 Emri i shoqerise do te jete "VOLAJ KP" SHPK

3.2 Shoqeria do te kete vulen dhe logon e saj personal.

3.3 Selia e shoqerise do te jete ne Shkoder rruga Tom Kola , nr pasurie 11/121, zona kadestrale 8593 Vol 23 faqe 49 .kati perdhe

3.4 Veprimtaria e saj do te shtrihet ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë shtetit. Shoqeria ka te drejte te krijojë brenda dhe jashtë vendit dege, zyra perfaqesimi.

Me vendim te asamblese se pergjithshme mund te krijohen, te ndryshohen ose anulohen (nese jane te krijuara) dege dhe zyra perfaqesimi brenda dhe jashte Shqiperise.

### Neni 4 Objekti I veprimtarise

Shoqëria ka objekt veprimtarie si me poshte :

- Kryerje ndertime civile dhe ekonomike , ndertime rruge , ndertime hekurudha , ndertime diga , galeri tunele , damba , ndertime , vepra kullimi , ujitje toke dhe impiante vaditese , punime dheu , punime mbrojtese dhe sistemime hidraulike, sillosa, kulla , kulla uji prej beton armeje, sillosakulla , kulla uji metalike , rikonstruksione godinash civile , ekonomike , veshje fasadash , mirembajtje dhe zhvillim dekorine mjedise urbane , projektim i veprave te zakonshme prej muraturen tulle, guri , betoni , beton armeje, metalike , punime montimi ne impiantet e prodhimit dhe shperndarjes se energjise.import eksport , perpunim druri , Import eksport i artikujve ushqimor , fruta perime dhe tregtim i tyre , Tregtim me shumice dhe pakice i gazit te lengshem nafte dhe derivatet e saj. Perpunim dhe tregtimi lëndes drusore, prodhim dhe tregtim te artikujve te ndryshem te mobilerive, tregtim te artikujve te ndryshme te parketeve, tregtim tev artikujve te ndryshem te lendeve te ndertimit ( bojra , materiale plastike etj.) te artikujve te ndryshem industrial, ushqimore dhe blegtoral, konfeksione makineri dhe paisje elektroshtepiake, hidrosanitare, elektronike, kozmetike dhe lijra per femije. Tregtimin e te gjithë artikujve te mesiperm me shumice dhe pakice import-eksport. Ne fushen e blerjes e shitjes se artikujve te ndryshem, shfrytezim pylli, ne fushen e pyllezimeve e permiresimeve dhe zbatimin e punimeve ne fushen e mbareshtimit te pyjeve, rrugeve pyjore dhe studim e projektim. Mbrojtje nga



semundjet demtuesit dhe zjarret. Sherbim katering, prodhim, perpunim, tregtim dhe shperndarje te artikujve ushqimore. Organizim banketesh, koktejsh, festa private, dreka, darka familjare, dhe ne fushen e ndertimit. Punime mermeri. Tregtim me shumice, artikuj kancelarie. Transport kombetar dhe nderkombetar mallrash dhe udhetaresh. Grumbullim dhe pastrim mbetjesh urbane dhe industriale, trajtim, asgjesim, perpunim i rmbetjeve urbane dhe industrial, rehabilitim mjedisi dhe i zonave te ndotura, mbjellje fidanesh pyjore dhe punime biologjike ne mjedis, peshkim dhe turizem. Grumbullim dhe perpunim i bineve medicinale. Montim dhe ç'montim skeleri. Mbareshtim bagetive te imta dhe te trasha, i zogjve, brojlera, pula, shpende. Import dhe tregtim i pajisjeve industriale agroperpunuese dhe bujqesore. Prodhim dhe shitblerje i produkteve bujqesore. Prodhim dhe shitje e pijeve alkoolike. Shitblerje te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme.

#### **Neni 5**

#### **Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar.

#### **KREU II**

#### **KAPITALI**

#### **Neni 6**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100000 (njqind mije) lekë dhe eshte teresisht kapital financiar nenshkruar dhe shlyer teresisht ne te holla nga ortaku i shoqërisë përkatësisht:

**z. Kristjan Nikoll Prendi**, me 100 % te kuotave

Kapitali është i ndare në 1 kuot me vlere 100000 leke

Me vendim te Asamblese se ortakeve kapitali mund te rritet sipas formave te parashikuara nga ligji.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve, deri ne vlerën e kontributit të tij ne kapitalin themeltar te shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë.

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

#### **Neni 7**

#### **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rasta zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit qëpërfaqësoj në.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".



## **Neni 8**

### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave te treteve jashte shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Nr Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve. Pjesët e kapitalit themettar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie,

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

## **Neni 9**

### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqërisë qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; gj) riorganizirnin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.



V2024040190100151746

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 10**

##### **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e tui dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### **Neni 11 Kuorumi dhe Marrja e vendimeve**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë  ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas paragrafit tre të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në këtë nen, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose në statut, për çështjet e tjera, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështjet si me poshte:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë, etj.
- Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

#### **Neni 12 Administrimi**

##### **Administrator i shoqërisë do të jete Kristjan Prendi për një periudhë 5 (pese) vjeçare ) duke filluar ky afat nga date 26/07/2024 deri me 25/07/2029**

Shoqëria do të administrohet nga një ose më shumë administrator të cilët do të ushtrojnë detyrat e administrimit sipas statutit dhe ligjit sipas vendimit ortakëve.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të



V2024040190100151746

zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori/et shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej  ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administatores dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administrator i shocierise mund te emerohet edhe nje person jashte ortakewise

### **Neni 13 Kompetencat**

#### **13.1 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:**

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

#### **13.2 Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur:**

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme.
- b) Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm.
- c) Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve, bankat e te gjitha niveleve etj.
- d) Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si përpara Bankave te te gjitha nivele, per te kryer derdhje, terheqje, transferta, etj, perpara ,7.yr e te Tatim Taksave, Zyrave te Qeverisjes Vendore, Zyrave te Punes, Autoriteteve Doganore, etj, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve te shoqerise.
- e) Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet rne të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

### **Neni 14 Përgjegjesite**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve



V2024040190100151746

14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shogerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

#### **Neni 15**

##### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shogerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### **Neni 16**

##### **Bilanci i shoqerise dhe dividendet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori/et.

Mbledhja e Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividendit,, siç edhe parashikohet nga ligji.

#### **Neni 17**

##### **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje rne kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultati të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, te cilat eshte i detyruar ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

#### **Neni 18**

Të ardhurat neto qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi te ortakeve.

#### **Neni 19**

Shperndarja ose prishja e shocierise mund të behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendirn të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) me vendim t ë gjykatës;

Ne kete rast Ortaku merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "*Shoqeri ne likuidim e siper*".



V2024040190100151746

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku.

Nëse Ortaku nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, gjykata emeron një likuidator.

#### **Neni 20**

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat

e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit. Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit/eve.

#### **Neni 22**

##### **Të drejtat e detyrimet e likuiduesit**

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit "**Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare**", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithsh

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE SHKODËR  
NOTER VALBONA XH. HAJDARI



Neni 22

Përfundimi

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "**Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit**".

Neni 23

Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 24

Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblese se Ortakeve, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008.
3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:
  - a) kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;
  - b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
  - c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "**Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit**" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 25

Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te saj në shoqëri aksionare Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 26

Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen **dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"**, Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise.



V2024040190100151746

### Neni 27

#### Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti si dhe per cdo mosmarrreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve do te jete kompetetnte Gjykata Shqiptare

NENI 28

DISPOZITAT E PERFUNDIMATRE

Ky statut u hartua ne tre kopje origjinale ME PERMBAJTJE DHE VLERA TE NJEJTA HURIDIKE , NE GJUHEN SHQIPE , U MIRATUA NE PARIM NEN PER NEN NGA Ortaku i shoqerise tregtare VOLAJ KP“ SHPK nenshkruset ne gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen origjinale

**Ortaket i vetem shoqerise “VOLAJ KP” Shpk**

KRISTJAN PRENDI

Kristjan Prendi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE SHKODËR  
NOTER VALBONA XH. HAJDARI



V2024040190100151746

DATE 26/07/2024  
NR REP 3080

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 26.07.2024 , para meje Notere VALBONA XH. HAJDARI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore SHKODËR, me zyrë në adresën Shkoder, NR.1, MYZAFER PIPA, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUES/IT:**

KRISTJAN PRENDI, atësia NIKOLL, amësia MARTE , shtetas Shqiptar, lindur në SHQIPERI dhe banues në UK, me adresë 54 French Avenue, Mile Oak, Tamworth , B78 3pb, lindur më 21/12/1997, gjendja civile "I MARTUAR", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Patenta e Re nr. FB30809422 dhe nr. personal prend912217k99pd , .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, Statut i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "VOLAJ KP" , bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER  
VALBONA XH. HAJDARI

